

**M**ontatorit Jozef Blohu që kishte qenë dikur një portier futbollit me emër, kur u paraqit një paradite në punë, iu njoftua se qe pushuar. Të paktën kështu e interpretoi ai, nisur nga fakti që kur ai u shfaq në derën e barakës, përveç përgjegjësit, askush nga punëtorët që qëlluan aty atë çast nuk i ngriti sytë nga kafja, dhe Blohu braktisi kantierin. Jashtë, në rrugë, ngriti krahun, por makina që i kaloi përpara - megjithëse Blohu nuk kishte thirrur ndonjë taksist - nuk ishte taksist. Pastaj dëgjoi mu para tij një zhurmë frenimi; Blohu u kthye: prapa tij qëndronte një taksist, taksisti po turfullonte; Blohu u rrotullua sërish nga ana tjetër, hipi dhe i tha shoferit ta shpinte në Naschmarkt.

Ishte një ditë e bukur tetori. Blohu hëngri një salçicë të nxehtë në një kioskë, pastaj kaloi përmes tezgave të tregut për në kinema. Gjithçka që shihte, e bezdiste; u përpoq të përkapte sa më pak të ishte e mundur. Brenda në kinema mori frymë lirisht.

Më pas do ta çudiste sportelistja, e cila i qe përgjigjur gjestit të tij të vendosjes së parave në pjatën rrotulluese të sportelit, pa hapur gojën, me një tjetër gjest, në mënyrë më se të natyrshme. Pranë ekranit të filmit vërejti një orë elektrike me fushë të ndriçuar. Nga mesi i filmit dëgjoji të binte një kambanë; për një kohë të gjatë nuk i dha dot dum, nëse kumbonte në film apo jashtë, në kambanoren pranë Naschmarkt.

Kur doli nga kinemaja, bleu rrush që në këtë stinë ishte me çmim tejet të leverdishëm. Vazhdoi të ecte duke ngrënë rrushin dhe hedhur zhapat. Hoteli i parë ku kërkoi një dhomë e refuzoi, sepse kishte me vete vetëm një valixhe diplomatike; portieri i hotelit të dytë që ndodhej në një rrugicë anësore, e shoqëroi personalisht deri në dhomë. Ende pa dalë portieri, Blohu u shtri në shtrat dhe ra në gjumë.

Në mbrëmje doli nga hoteli dhe u bë tapë. Mandej u bë prapë esëll dhe u mundua t'u telefononte ca miqve; por meqenëse këta miq shpesh nuk jetonin në qytet dhe telefoni nuk i kthente mbrapsht monedhat, Blohut iu mbaruan gjitha monedhat. Një polic, të cilin e përshëndeti duke menduar se ky do të ndalonte, nuk ia ktheu përshëndetjen. Blohu pyeti veten, nëse polici mund t'i kishte keqinterpretuar fjalët që ai kishte gërthitur nga ana tjetër e rrugës, dhe aty

iu kujtua natyrshmëria, me të cilën sportelistja e kinemasë kishte rrotulluar drejt tij pjatën, ku ndodhej bileta e tij. Kaq shumë ishte shastisur nga shpejtësia e lëvizjes së saj, sa mend harroi të merrte biletën. Vendosi të takonte sportelisten.

Kur arriti para kinemasë, dritat e vitrinave sapo u fikën. Blohu pa një burrë hipur mbi shkallë që po zëvendësonte shkronjat e filmit me titullin e nesërm. Priti derisa të mund të lexonte titullin e filmit tjetër; pastaj u kthye në hotel.

Dita tjetër ishte një e shtunë. Blohu vendosi të qëndronte në hotel edhe një ditë. Përveç një çifti amerikan, ndodhej i vetëm në sallën ku shërbehej mëngjesi; një copë here mbajti vesh bisedën, të cilën deri diku e kuptonte, meqë dikur kishte qenë disa herë me skuadrën e tij për turne në New York; pastaj doli jashtë me shpejtësi të blinte ca gazeta. Gazetat, meqë bëhej fjalë për numrat e fundjavës, atë ditë ishin veçanërisht të rënda; Blohu nuk i palosi, por u kthye në hotel me tonën sjetull. U ul sërish në tryezën e mëngjesit, e cila sakaq ishte pastruar, shkëputi prej gazetave fashikujt e njoftimeve; kjo e angështoi. Jashtë pa dy persona tek ecnin me gazeta të trasha. Mbajti frymën derisa ata kaluan. Vetëm atëherë e dalloj që bëhej fjalë për dy amerikanët; ngaqë më herët i kishte parë vetëm në sallën e mëngjesit, përjashta nuk i kishte njohur.

Në një kafene, më pas, piu gjatë ujë rubineti që e shërbenin me një gotë bashkë me kafenë. Herë pas here ngrihej të merrte ndonjë revistë nga stivat mbi karriget dhe tryezat e përshtatura për atë punë; kamerierja, duke marrë me vete revistat e bëra parg pranë tij, përdori në ecje e sipër shprehjen “tryezë revistash”. Blohu, i cili nga njëra anë nuk e duronte dot shfletimin e revistave, nga ana tjetër, nuk e hiqte dot nga dora një numër pa e shfletuar komplet nga fillimi në fund, përpiquej herë pas here të hidhte një sy nga rruga; kontrasti mes faqeve të ilustruara dhe imazheve të ndryshueshme përjashta, e lehtësoi. Kur po dilte, i vuri personalisht revistat në tryezë.

Në Naschmarkt, kioskat qenë mbyllur sakaq. Njëfarë kohe, Blohu shtyu shkujdesshëm me këmbë perimet dhe frutat e hedhura, që i dilnin përpara. Kreu nevojat e tij diku mes kioskave dhe vërejti se gjithandej muret e barakave prej druri ishin nxirë nga urina.

Zhapat e rrushit që i kishte hedhur një ditë më parë, ndodheshin ende në trotuar. Kur Blohu vendosi kartëmonedhën në pjatën rrotulluese të sportelit, në lëvizje e sipër, kartëmonedha ngeci; Blohu pati rastin të thoshte diçka. Sportelistja iu përgjigj. Ai tha prapë diçka. Ngaqë kjo ishte diçka e pazakontë, sportelistja e vështroi. Kjo e shtyu atë të fliste akoma. Brenda në kinema, Blohut iu

kujtua libërthi romantik dhe furnela elektrike në krah të sportelistes; u mbështet pas dhe nisi të merrej me detajet në ekran.

Pasdite vonë i hipi tramvajit për në stadium. Bleu një vend në këmbë, por pastaj u ul mbi gazetat që nuk i kishte hedhur ende; fakti që spektatorët përpara tij i zinin pamjen, nuk e shqetësoi. Gjatë lojës shumë prej tyre u ulën. Blohun nuk e njohu kush. I la gazetat përtokë, u vuri përsipër një shishe birre dhe doli nga stadiumi përpara fishkëllimës finale të arbitrit, për të mos e kapur rrëmuja. Numri i madh i autobusëve dhe tramvajeve thujse të zbrazët në pritje para stadiumit - bëhej fjalë për një ndeshje të rëndësishme - e shqetësoi. U ul në një tramvaj. Qëndroi aq gjatë i ulur aty brenda, thujse vetëm, derisa filloi të priste. Po sikur arbitri t'ua kishte dhënë kohë shtesë? Kur Blohu ngriti sytë, pa që dielli po perëndonte dhe uli kokën, pa dashur të shprehte ndonjë gjë me këtë gjest.

Papritmas jashtë filloi era. Pothujse njëherazi me fishkëllimën finale, të përbërë nga tre fishkëllima të zgjatura veç e veç, shoferët dhe fatorinot hipën nëpër autobusë e tramvaje, dhe njerëzit dolën me vrap nga stadiumi. Blohu përfytyroi sikur po dëgjonte zhurmën, me të cilën shishet e birrës binin në fushën e lojës; njëkohësisht dëgjonte pluhurin të përplasej pas

xhamave. Nëse në kinema që mbështetur pas në shpinore, tani që spektatorët po shtyheshin në vagonin e tramvajit, u përkul përpara. Për fat, kishte një fletëpalosje të filmit me vete. Iu duk sikur në stadium sapo i kishin ndezur projektorët. Një mendim absurd, tha Blohu. Kishte qenë një portier i keq natën.

Në qendër kërkoi një copë here për një kabinë të lirë telefonike; dhe, kur e gjeti njërën bosh, receptori i telefonit dergjej mbi dysHEME, me kabëll të këputur. Vazhdoi të kërkonte. Në fund arriti të telefononte nga Stacioni Perëndimor. Duke qenë e shtunë, nuk gjeti njeri. Kur u përgjigj më në fund një grua, të cilën e kishte njohur dikur, atij iu desh të fliste ca minuta, derisa ajo ta kuptonte kush ishte. Lanë takim te një lokal afër Stacionit Perëndimor, ku, siç e dinte Blohu, ndodhej një xhuboks. Në pritje të gruas, e kaloi kohën duke futur xhetona në automatin muzikor dhe duke lënë personat e tjerë të shtypnin butonat në vend të tij; ndërkaq vështronte fotografitë me firmat e futbollistëve mbi mure; lokali ishte marrë me qira vite më parë nga një sulmues i kombëtares, i cili më vonë që larguar përtej oqeanit si trajner i një prej skuadrave më të forta të ligës amerikane, dhe tani, pas shkrirjes së ligës, që zhdukur pa lënë gjurmë. Blohu hyri në bisedë me një vajzë në tryezën ngjitur me xhuboksin, e cila shtypte

verbërisht butonin pas saj, duke zgjedhur gjithmonë të njëjtin disk. Dolën nga lokali së bashku. Ai u përpoq të futej me të në ndonjë ndërtesë, por portat ishin gjithandej të mbyllura. Kur mundën ta hapnin njëerën prej tyre, gjykuar nga lloji i muzikës, u duk se përtej portës tjetër po mbahej një meshë. Hynë në një ashensor që ndodhej mes të dy portave; Blohu shtypi butonin e katit të fundit. Përpara se ashensori të vihej në lëvizje, vajza kërkoi të dilte. Blohu atëherë shtypi butonin e katit të parë; dolën që aty dhe qëndruan në krye të shkallares; tani vajza sikur u zbut. Filluan t'i ngjisnin shkallët së bashku. Ashensori ishte në katin e fundit; hynë brenda, zbritën poshtë dhe dolën jashtë, në rrugë.

Blohu eci përbri vajzës njëfarë kohe, pastaj u kthye dhe shkoi në lokal. Gruaja, me pallton ende veshur, po e priste. Blohu i shpjegoi shoqes së vajzës, ende në pritje të tryeza pranë xhuboksit, se vajza nuk do të kthehej dhe doli nga lokali me gruan.

Blohu tha: “Më duket vetja qesharak, kështu, pa pallto, ndërsa ti ke veshur pallto.” Gruaja i futi krahun. Për të çliruar krahun, Blohu bëri gjoja sikur donte t'i tregonte diçka. Mandej nuk dinte çfarë t'i tregonte. Papritmas i hipi dëshira të blinte një gazetë të mbrëmjes. Kaluan nëpër rrugë të ndryshme, pa ndeshur as edhe një shitës. Së

fundmi, shkuan me autobus në Stacionin Jugor, por stacioni qe mbyllur tashmë. Blohu bëri sikur u tremb; por realisht ishte i trembur. Gruas, e cila qysh në autobus, duke luajtur me çantën e saj të dorës dhe do sende aty brenda i kishte lënë të kuptonte se nuk qe e disponueshme, i tha: “Harrova të lija një shënim”, pa e ditur se çfarë nënkuptonte realisht me fjalët “shënim” dhe “të lija”. Sidoqoftë, hipi i vetëm në një taksi dhe u nis për në Naschmarkt.

Meqenëse të shtunave kinemaja transmetonte një shfaqje vonë në mbrëmje, Blohu arriti më herët nga sa duhej. Shkoi në një restorant me vetëshërbim aty pranë dhe hëngri një qofte, në këmbë. U rrekt i tregonte një barcaletë kamerieres sa më shpejt që mundej; kur koha mbaroi dhe ai ende nuk kishte përfunduar, e ndërpreu fjalinë në mes dhe pagoi. Kamerierja qeshi.

Në rrugë takoi një të njohur që i lypi para. Blohu i futi një të sharë. Kur i dehuri e kapi Blohun prej këmishe, rruga papritmas u zhyt në terr. I dehuri lëshoi dorën i trembur. Blohu që kishte pritur të fikeshin dritat e kinemasë, u largua me nxitim. Para kinemasë takoi sportelisten; ajo po hipte në makinën e një burri.

Blohu e vështroi. Sportelistja, e ulur sakaq në sediljen pranë shoferit, ia ktheu vështrimin duke ndrequr fustanin që ishte kapur keq në ndenjësë;